

NOTË INFORMUESE

Tiranë, më 11.05.2023

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Ulje page deri në 40% për një periudhë deri në 1 vit” për gjyqtarin B.M. dhe “Vërejtje publike” për gjyqtarin R.A.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor për zvarritje gjykimi mbi 2 vjet, ndaj gjyqtarëve I.M., B.M., Z.Sh., R.A., M. Ç. dhe Z.V., pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në kohën e shkeljes së pretenduar, hetim ky i nisur nga ish Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mars 2017, bazuar në informacionin e kryetarit të gjykatës Elbasan për muajin Dhjetor 2016, dosje e transferuar për trajtim pranë ILD-së në shkurt 2021. Në kushtet kur ka rezultuar se kryesisht nuk ekzistojnë elementë të shkeljes disiplinore, hetimi disiplinor i nisur është mbyllur për magjistratët I.M., Z.Sh., M. Ç. dhe Z.V., gjyqtarë pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në kohën e shkeljes së pretenduar, ndërsa për gjyqtarët B.M. dhe R.A. është vendosur fillimi i procedimit disiplinor, respektivisht për çështjet gjyqësore civile që datojnë të regjistruara në gjykatë më 23.07.2009 dhe më datë 24.09.2014.

Procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit B.M lidhet me gjykimin e çështjes të regjistruar në vitin 2009, që i përket padisë së 19 paditësve me objekt lirim dhe dorëzim sendi. Vlen të theksohet, se kjo çështje civile është ende në proces gjyqësor në Gjykatën Elbasan, por nuk vijon nga gjyqtari B.M., i pezulluar nga detyra për shkak të shkarkimit nga KPK në shtator 2021, në pritje të vendimmarrjes finale nga KPA.

Nga hetimi disiplinor i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se:

- Vonesat e gjyqtarit B.M., përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë zvarritjen e pajustificuar të çështjes gjyqësore, (ende në proces), për një afat mbi 12 vite, 5 muaj e 19 dite, duke mos marrë masat e duhura me karakter procedural për përfundimin e kësaj çështje civile brenda një afati të arsyeshëm.
- Gjyqtari nuk ka marrë masat e nevojshme për zhvillimin efektiv të seancave dhe për shmangien e shtyrjeve, veçanërisht për shkak të mungesës ose mosnjohimit të palëve dhe ekspertës. Nga 88 seanca të planifikuara, 51 kanë rezultuar joproduktive. Masat ndaj mungesave kanë qenë të kufizuara, pasi gjoba sipas nenit 167 të K.Pr.Civile është aplikuar vetëm një herë. Gjithashtu, gjyqtari ka munguar në 4 seanca, ndërsa në 3 raste nuk është pasqyruar shkakun e mungesës në procesverbalet përkatëse.
- Hetimi nuk konstatoi shkaqe që justifikojnë kohëzgjatjen e procesit dhe vlerësoi se gjyqtari ka vepruar me pakujdesi të rëndë, në formën e neglizhencës, pa u provuar se vonesat kanë qenë të qëllimshme. Kjo sjellje ka cenuar besimin e publikut në një drejtësi efektive dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Nga tërësia e hetimit disiplinor konkludohet se veprimet e mosveprimet e magjistratit përbëjnë “shkelje të rëndë disiplinore”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor pranimin e propozimit për caktimin e masës disiplinore “ *Ulje e pagës, deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit*”, për gjyqtarin B.M., për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.